

ETILDA GJONAJ



Datëlindja: 6.5.1981

Vendlindja: Tiranë

E-mail: Etilda.Gjonaj@parlament.al

Jetëshkrimi:

Është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (1999-2003). Ka kryer studimet dyvjeçare pasuniversitare për master shkencor në shkenca penale në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (2009 – 2011).

Mban titullin “Doktor shkencash” në shkenca penale, ndjekur pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Ka kryer një sërë trajnimesh dhe specializimesh brenda dhe jashtë vendit për çështjet e të drejtave të njeriut, sistemin e drejtësisë, sistemin penitenciar dhe shërbimit të provës, sistemin elektoral, ndihmën juridike për grupet në nevojë, në organizata ndërkombëtare, institucione të Bashkimit Europian, etj.

Ka qenë zëvendësministre e Drejtësisë për periudhën maj - shtator 2017 dhe mbajti postin e ministres së Drejtësisë në vitet 2017-2021.

Ka ushtruar funksionin e komisionerit në institucionin e Avokatit të Popullit për një mandat 3-vjeçar, ku ka drejtuar Seksionin e Çështjeve të Administratës Publike qendrore dhe vendore (2014-2017). Për rreth dy vjet e gjysmë ka qenë eksperte e Sekretariatit Teknik, të ngritur pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar të Reformës në Drejtësi (2015-2017).

Ka qenë aktiviste e shoqërisë civile, duke ofruar një kontribut për më shumë se 11 vjet për të drejtat e njeriut. Përgjatë periudhës 2003–2014 ka kontribuar si drejtuese programesh për programet e drejtësisë, reformave ligjore dhe institucionale, të zgjedhjeve dhe litigimit strategjik të çështjeve të drejtave të njeriut në Komitetin Shqiptar të Helsinkit. Për disa vite është angazhuar si pedagoge e jashtme në Departamentin Penal të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Ka shërbyer si eksperte dhe konsulente në një sërë organizatash vendase dhe të huaja, me fokus të drejtat e njeriut dhe çështjet e drejtësisë, për monitorimin e ecurisë së Shqipërisë në procesin e integrimit evropian dhe zbatimit të rekomandimeve të KE-së (2007–2012 Fondacioni Soros), monitorimin e ecurisë së planeve të qeverisë për luftën ndaj korrupsionit të plan veprimeve për çështjet e drejtësisë (2011–2013), për drejtësinë penale për të miturit, masat e sigurisë dhe dënimet alternative, për çështjet penale, litigimit strategjik dhe ndihmës juridike.

Është autore e një sërë publikimesh, studimesh kërkimore dhe shkrimesh shkencore në revista juridike vendase dhe ndërkombëtare në fushën e drejtësisë, si dhe lektore në një sërë trajnimesh, konferencash dhe seminaresh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.